



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 15.04.2013  
Nr. 0204 - 424

**PËR:** Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës  
Fadil Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË  
KLINËS, 01 Nr. 07 - 1996/13, Pranuar me datë, 08.04.2013**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01Nr.07-1996/13, të miratuar me datë 29.03.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .


Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim 01 Nr. 07 - 1996/13, për Zgjerimin e Përbërjes së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 15.04.2013  
br. 0204 - 424

**Za:** Sokol Bashota, Gradonačelnik opštine Klina  
Fadil Gashi, Predsedavajući Skupštine opštine Klina

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluke opštine Klina , 01 br. 07 - 1996/13, primljeno  
dana , 08.04.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br.07-1996/13, odobreno dana 29.03.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01 br. 07 - 1996/13, o proširenju sastava opštinskog saveta za Zajednice.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.



Duke u mbështetur në nenin 40 nënparagrafi 40.2 nënparagrafi nën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 2 nënparagrafi i fundit të Statutit të Komunës, nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 gjerë të 1.14 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, me preferencën e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të, të radhës, për vitin 2013, të mbajtur me dt. 29.03.2013, mori këtë:

V E N D I M  
Për

Zgjerimin e Përbërjes së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi

I

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi zgjerohet duke plotësuar vendet e zbrazëta me emra dhe mbiemra nga Kryetari i Komunës:

1. Kryetari i Komunës-Sokol Bashota,
2. Komandanti i Stacionit të Policisë në komunë-Rexhë Berisha,
3. Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës  
Fitim Bojaj dhe  
Lorenc Sopi,
4. Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës:  
Gani Vrankaj  
Muhamet Tusha  
Azem Kerella  
Millorad Sharkoviq
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete-Sahit Balija
6. Zyrtari për Barazi Gjinore-Remzie Maloku
7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim-Ramiz Rrusta
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të komunës.....
9. Një përfaqësues i FSK-së.....
10. Një përfaqësues i secilit Këshillit Lokal për Siguri Publike:  
.....
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi-Have Thaqi
12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale.....
13. Përfaqësues i Zyrës komunale për komunitete.....
14. Një përfaqësues nga OJQ-Lale Grabanica,
15. Komuniteti i Biznesit-Beqir Qupeva,
16. Komuniteti i personave me aftësi të Kufizuara.....

II

Sipas Udhëzimit Administrativ të sipërpërmendur si në hyrje të këtij vendimi, neni 4, paragrafi 1 nënparagrafi prej 1-14, nuk parasheh përfaqësues të tjerë në këtë Këshill të Sigurisë në Bashkësi. Plotësimi i vendeve të lira behët nga Kryetari i Komunës.

III

Kompensimi i anëtarëve të këtij Këshilli shikohet me rishikimin e buxhetit për 2013.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm më nënshkrimin nga Kryesuesi i Kuvendit.

V

Më këtë vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, të gjithë përfaqësuesit e tjerë të Këshillit të Sigurisë së Bashkësive, një për Zyrën Ligjore, Zyrën e Informimit, Shërbimin e Kuvendit dhe Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 07-1996/13  
Klinë më, 03-04-2013

Kryesuesi,  
Fadil Gashi

